

LIGJ
Nr. 64/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT
TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA E
TRANSMETIMIT 400 KILOVOLT SHQIPËRI-KOSOVË (TIRANË-PRISHTINË)”,
NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 42 000 000 EUROSH**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si Agjencia e Zbatimit të Projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 (dyzet e dy milionë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

**Shpallur me dekreten nr. 9643, datë 14.6.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

KfW Bankengruppe, Postach 111141, 60046, Frankfurt am Main
Operatorit të Sistemit të Transmetimit
Engjëll Zeqo
Bulevardi “Bajram Curri”, rruga 5
Tiranë, Shqipëri

Ministria e Financave
Ministër Shkëlqim Cani

Për dijeni: Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Ministër Damian Gjikhuri

Datë: 2 shkurt 2016
KfW Development Bank
Peter Ley
Referenca jonë: PeLe
Phone: +49 69 7431-3412
Fax: + 49 69 7431-3490
Peter.Ley@kfw.de

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Shtyrja e Afatit të Disbursimit
Linja e transmetimit 400 kv Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)

Marrëveshja e Huas dhe projektit

Datë:	04 janar 2010
Vlerë:	42 milionë euro
BMZ no.:	2008 65 196
Llogaria e huas nr.:	2531222

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur dhe letrës së Ministrisë së Financës, të datës 3 dhjetor 2015, në të cilën kërkonti për një zgjatje të afatit të disbursimit.

Ne jemi të kënaqur që nëpërmjet kësaj t'ju informojmë ju, se ne pranojmë kërkesën tuaj dhe se kemi marrë miratimin e brendshëm që të mbartim vetë në këtë rast kostot shpenzimet e rifinancimit dhe jo t'ia ngarkojmë klientit.

Pas vonesave fillestare në zbatimin e projektit, me këtë pranojmë ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes:

Seksioni A, “Ndryshimin e Marrëveshjes së Huas”;

Marrëveshja e Huas (BMZ-No. 2008 65 196) do të ndryshojë si më poshtë:

Neni 3.2 “Afati i fundit për të kërkuar disbursimin”, do të fshihet dhe do të zëvendësohet si vijon:

“KfW-JA mund të refuzojë disbursimet pas 30 dhjetorit 2017. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të realizojë shtyrjen e afatit, duke informuar Huamarrësin sipas gjykimit të saj.”.

Seksioni B, “Dispozita të tjera”

1. Kjo letër nuk do të ndryshojë ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e Marrëveshjes së Huas, përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 10 (“Kostot dhe detyrimet publike”), neni 11.5 (“Pajtueshmëria”), neni 13.2 (“Adresat”), neni 14.3 (“Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet”), dhe neni 14.4 (“Forma e shkruar dhe amendimet”), neni 14.6 (“Ligji i zbatueshëm”) dhe 14.9 (“Mosmarrëveshjet ligjore – Arbitrazhi”) i Marrëveshjes do të përfshihen në këtë letër, sikurse është e përcaktuar në mënyrë të plotë në këtë letër dhe sikurse referencat në ato dispozita të Marrëveshjes i referohen kësaj letre.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përmendura më lart, duke nënshkruar në një formë ligjërishit të detyrueshme dhe kthimin e një prej kopjeve të ne sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,

KfW

Rainer Sunnen
Senior Project Manager
KfW Entwicklungsbank

Peter Ley
Project Manager
KfW Entwicklungsbank

Lexuar dhe pranuar:

Tiranë: _____2016

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë

Emri:

Titulli: